



concordia

PROJEKTE SOCIALE

CONCORDIA Projekte Sociale - Kosovë
Raporti Vjetor 2023

Misioni ynë

CONCORDIA është një organizatë ndërkombëtare, e pavarur, joqeveritare, e dedikuar për të mbështetur fëmijët, të rinjtë dhe familjet në nevojë, drejt një jete më të pavarur dhe më të përgjegjshme.

Ne shkojmë aty ku ka më shumë nevojë. Dhe aty ku të tjerët nuk shkojnë.



LIDHJA ME ZEMËR

Ne lidhemi nga zemra në zemër.



PËRKUSHTIMI

Njerëzit mund t'i besojnë në përkushtimin tonë.



GUXIMI

Jemi të përcaktuar të shkojmë atje ku ka më shumë nevojë.



MUNDËSITË

Ne ofrojmë shpresë duke i rritur mundësitë.





Të nderuar miq,

"Dinjiteti njerëzor është i pacenueshëm" - ky koncept është në qendër të vëmendëjs dhe është ajo që drejton punën tonë të përditshme në CONCORDIA çdo vit.

Ky dinjitet cenohet kur fëmijët lindin në botë pa iu dhënë mundësia për të përmbushur potencialin e tyre për shkak të rrethit vicioz të varfërisë ndër breza që ekziston ende sot nëpër disa vende të Evropës.

Për 32 vite ne përpiqemi ta thyejmë këtë rreth vicioz individualisht dhe sistematikisht. Në vitin 2023, ne zgjeruam sferën tonë të ndikimit dhe arritëm gjithsej 27,000 fëmijë, të rinj dhe të rritur në nevojë. Këto numra pasqyrojnë angazhimin dhe vendosmërinë tonë për të ruajtur dhe promovuar dinjitetin e të gjithëve nën kujdesin tonë.

Lufta e tmerrshme në Ukrainë arriti kulmin vitin e kaluar. Si rezultat i saj, ne mbështetëm mbi 8000 refugjatë: në Austri, Rumani dhe Bullgari, duke u fokusuar në integrimin social. Në Moldavi, (ku mbi 100,000 njerëz gjetën strehim gjatë vitit 2023), ku shumica udhëtojnë në varësi të intensitetit të bombardimeve në rajonin e tyre dhe shumica e fëmijëve vazhdojnë të marrin mësim online nga mësuesit e tyre Ukrainas. Përderisa lufta vazhdon, ne do të qëndrojmë pranë këtyre njerëzve.

Komuniteti më i gjerë i CONCORDIA's vazhdon të rritet dhe tani përfshin 120,000 njerëz që na mbështesin rregullisht, kryesisht nga rajoni DACH (Evropa Qendrore, Gjermania, Austria dhe Zvicra) por edhe në vendet e programit tonë. Ne kemi hyrë në partneritete strategjike me organizata ndërkombëtare që ndajnë misionin tonë. Deri më sot kemi njëmbëdhjetë "partneritete krenare" me kompani që na mundësojnë të vazhdojmë punën tonë të pandërprerë dhe me fuqi bashkëpunuese.

Lufta për një jetë dinjitoze është në qendër të misionit tonë. Kjo mbështetet nga 550 punëtorë të përkushtuar dhe mbi 450 vullnetarë në shtatë vende, si dhe nga komuniteti CONCORDIA's dita ditës në rritje, të cilët u mundësojnë fëmijëve të hapin krahët e tyre. Poashtu, një falenderim të gjithëve atyre që kontribuan në 2023.

Me respekt,


Pater Markus Inama SJ
Anëtar i Bordit


Ulla Konrad
Anëtar i Bordit


Bernhard Drumel
Anëtar i Bordit


Cornelia Burtscher
Anëtar i Bordit


Thomas Birtel
Kryesues i Bordit



Të dashur fëmijë, kolegë dhe partnerë,

Me kënaqësi të madhe ju ftoj të lexoni raportin tonë të tretë vjetor, raportin për vitin 2023. Do të keni kënaqësinë të mësoni për përpjekjet e palodhura të CONCORDIA-s në Kosovë, ku përkushtimi dhe lidhjet tona të përzemërta kanë ofruar mundësi të jetës më të mirë dhe guxim për të thyer ciklin e varfërisë për shumë fëmijë të paprivilegjuar dhe familjet e tyre.

Në vitin 2023, 153 fëmijë dhe të rinj kanë përfituar (pranuar) në baza ditore për krahe arsimore dhe shërbimet psikosociale në CONCORDIA Qendrën Tranzit në Prizren. Në përgjithësi, 757 individë kanë pranuar mbështetje bazuar në nevojat e tyre dhe mundësitë e qendrës sonë. Këto suksese janë arritur falë ekipit të përkushtuar të CONCORDIA-s, mbështetjes bujare të donatorëve tanë, besimit të autoriteteve qendrore dhe lokale si dhe bashkëpunimeve të vlefshme me OJQ-të të tjera.

Puna jonë me cilësi të lartë, është mirratuar me përfitimin e liçencës si Qendër Mësimore e bazuar në komunitet nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, dhe nga anëtarësimi ynë në Koalicionin Kosovar të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF). Këto arritje kanë forcuar vendosmërinë dhe motivimin tonë për të vazhduar dhe zgjeruar mbështetjen tonë në tërë vendin.

Ju jemi falenderues të gjithë juve si dhe shpresojmë në mbështetjen tuaj të vazhdueshme!

**Mirela Lavric
Drejtoreshë Ekzekutive**

Statistikat vendore

Popullata:
1.587 MILION (2024)

Pagat:
521 € BRUTO (2023)

Papunësia:
Q1: 16.6% - (2023)

Inflacioni:
Norma në Kosovë
rritur për 2,8 %
në qershor 2023,
krahasuar me të
njëjtin muaj të
vitit të kaluar.



CONCORDIA Kosovë- Statistikat

KOSOVË			Kujdesi për emigrant	Mobilizimi dhe krahimi në komunitet	Edukimi dhe formimi profesional	Punësimi dhe biznesi social	Futurimi
EMRI I PROJEKTIT	VENDI	QË NGA					
CONCORDIA Tranzit Qendra Ditore/ Qendra Mësimore	Prizren	2021		641	120		
Ekipi mobil - puna në terren në Komunën e Prizrenit	Prizren	2022		109			
Këshillim Profesional	Prizren	2022			10	6	
Grupi Mbështetës i Grave	Prizren	2022					10
Shkolla për Prindër	Prizren	2022					10
Klasat e Muzikës	Prizren	2021			67		
Edukimi në fëmijërinë e hershme	Prizren	2021		7	26		
Nuërimi për person - përfituesit unikë	916		0	757	223	6	20
Numërimi i dyfishtë - kjo vlen për pjesëmarrësit e programit që përdorin më shumë se një shërbim nga CONCORDIA.							

Qendra Ditore CONCORDIA Tranzit/Qendra mësimore:

- 641 prindër dhe anëtarë të tjerë të familjes që jetojnë nën të njëjtën çati të atyre fëmijëve që vijnë në baza ditore në Qendër (pako ushqimore, mbështetje shëndetësore, takime me prindër, këshillim social, vizita nëpër shtëpia);
- 120 Numri në krye të personit/ per person - Fëmijë dhe të rinj që vijnë në baza ditore në Qendrën Tranzit (për detyra të shtëpisë, mjete shkollore, rroba, kohë të lirë, këshillim psikologjik, këshillim profesional, mbështetje shëndetësore etj).

Ekipi mobil - puna në terren në Komunën e Prizrenit:

- 109 Numri total i individëve të 10 familjeve të mbështetura nga ekipi mobil.

Këshillim Profesional:

- 10 fëmijë që marrin pjesë në 12 module në baza mujore;
- 6 të rinj dhe të rinj të regjistruar si punëkërkes/klasa profesionale/të punësuar.

Grupi Mbështetës i Grave:

- 10 gra marrin pjesë në 12 module në baza mujore.

Shkolla për prindër:

- 10 prindër marrin pjesë në 12 module në baza mujore.

Klasat e muzikës:

- 67 fëmijë dhe të rinj të regjistruar në orët e muzikës - 49 në instrumente muzikore, 18 në kor, 4 prej tyre vijnë vetëm për orë të muzikës, pjesa tjetër janë pjesëmarrës në Qendrën Ditore Tranzit.

Edukimi në fëmijërinë e hershme

- 7 në Çerdhe - më shumë kujdes se edukimi - në baza ditore në Qendrën Tranzit;
- 26 Parashkollor - vijnë në baza ditore në Qendrën Tranzit.



Arsimimi- intervenimi kryesor

Viti i tretë i CONCORDIA-s në Kosovë, me një fjalë mund të përshkruhet si “rritje dhe profesionalizim i mëtejshëm” i mbështetjes që u ofrohet fëmijëve, të rinjve dhe familjeve më të cënueshme në Komunën e Prizrenit.

Konfigurimi i ri i Qendrës Tranzit mbështetet edhe nga licenca e Qendrës Mësimore e zyrtarizuar në Prill 2023, pas vlerësimit të aplikimit nga komisioni i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI-t).

Projektet tona kryesore

Përderisa që ndërhyrjet e reja filluan vitin e kaluar (Shkolla për Prindër, Ekipi Mobil, Këshillimi Profesional, Grupi për Mbështetjen e Grave) u rritën dhe u zhvilluan si projekte, dhe ne konfiguruam CONCORDIA Qendrën Tranzit si një program me 7 projekte, si:

- ▶ **CONCORDIA Qendra Dltore Tranzit/ Qendra Mësimore;**
- ▶ **Ekipi mobil - puna në terren në Komunën e Prizrenit;**
- ▶ **Këshillimi Profesional;**
- ▶ **Grupi Mbështetës i Grave;**
- ▶ **Shkolla për prindër**
- ▶ **Klasat e Muzikës;**
- ▶ **Edukimi në fëmijërinë e hershme.**





Mbështetje arsimore

Qendra Mësimore

Cilësia e mbështetjes arsimore e ofruar nga CONCORDIA Qendra Tranzit është mirraur nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI-t) duke dhënë licencën e Qendrës Mësimore me bazë në komunitet, në Prill 2023, në përputhje me dispozitat e Udhëzimit Administrativ 19/2018 si Qendër Mësimore, për fëmijët e cenuar dhe që ballafaqohen me pasojat socio-ekonomike.

Bëhen përgatitjet duke ofruar ndihmë shtesë me detyrat shkollore dhe duke ofruar aktivitete argëtuese dhe edukative që kontribuojnë në dekurajimin e braktisjes së shkollës. CONCORDIA Qendra Tranzit ofron të gjitha materialet mësimore didaktike pa pagesë, së bashku me çanta, veshje dhe këpucë për fëmijë. Ne ofrojmë gjithashtu shujtë të ngrohtë çdo ditë për të gjithë fëmijët që ndjekin Qendrën tonë Mësimore. Gjithashtu, prindërit dhe familjet e tyre mbështeten duke u ofruar pako ushqimore dhe higjienike, sipas mundësive tona, si dhe shërbime psikologjike dhe shëndetësore.

Në bazë të këtyre shërbimeve, synimi ynë është të përmirësojmë vijueshmërinë në shkollë dhe të mbështesim arritjet akademike. Këto shërbime ofrohen nga një ekip i përkushtuar mësuesish, edukatorësh dhe vullnetarësh që ndihmojnë fëmijët me nevojat e tyre arsimore. Gjithashtu, shërbime të tjera ofrohen nga psikologë, punëtorë socialë dhe infermierë.

- 80 fëmijë marrin mbështetje arsimore në Qendrën Mësimore Tranzit;
- Në dhjetor 2023 janë regjistruar 91 fëmijë dhe kanë marrë pjesë në aktivitetet ditore;
- 20 fëmijë janë regjistruar në parashkollor dhe kanë marrë pjesë në aktivitetet ditore; 11 fëmijë parashkollorë janë vlerësuar dhe janë regjistruar në klasën e parë në shkollë;
- 94% e nxënësve kanë kaluar vitin shkollor dhe vetëm një (1) nxënës ka përsëritur vitin.



Edukimi në fëmijërinë e hershme

Me marrjen e licencës së Qendrës Mësimore, duke filluar nga shtatori i vitit 2023, mbështetja arsimore e ofruar për fëmijët të vegjël është njohur zyrtarisht si arsim parashkollor. Kështu që, një grup prej 20 fëmijëve 5 deri në 6 vjeç, filluan edukimin e tyre specifik parashkollor sipas planprogrameve vendore, me mbështetjen e një mësuesi parashkollor dhe një asistenti. Përveç fëmijëve të grupit parashkollor, në grupin e çerdheve mbështeteshin në baza ditore 6 fëmijë më të vegjël (3 deri në 5 vjeç).

Programi ditor për edukimin në fëmijërinë e hershme është nga ora 8:30 deri në 15:00.

Më të vegjlit poashtu flejnë pas ngrënies së drekës. Aktivitetet janë të larmishme, kreative dhe argëtuese në baza ditore, ndërkohë dhe fëmijët mësojnë.

Këshillim Psikologjik

Pas vlerësimit psikologjik, psikologu ofron seanca individuale dhe/apo grupore për fëmijët dhe të rinjtë që synojnë mirëqenien e tyre emocionale.

Në shtator, të gjithë fëmijët e moshës parashkollore u vlerësuan në bazë të kurrikulës, e cila përfshin gjuhë dhe komunikim, matematikë, shkenca natyrore, mjedisi dhe shoqëria, art dhe edukim fizik dhe shëndetësor.

Veç këtyre lëndëve, mbahen seanca vlerësimi dhe seanca stimulimi për mirëqenien më të mirë të fëmijëve, duke përfshirë seancat javore të terapisë së artit, ku fëmijët mësojnë të përqendrojnë vëmendjen e tyre në aktivitete krijuese duke ushtruar sjellje të mirë dhe duke zhvilluar aftësi të ndryshme. Këto seanca i ndihmojnë fëmijët të shprehin më lirshëm, të përmirësojnë shëndetin e tyre mendor dhe të përmirësojnë marrëdhëniet ndërpersonale.

Sipas rekomandimit të mjekut psikiatër, 9.4% (12) e fëmijëve kanë PIA (planin e ndihmës individuale në shkollë), por shkollat nuk kanë mundësi të ofrojnë mësues plotësues.

Gjithashtu, 40% e fëmijëve në Tranzit janë diagnostikuar me mungesë vëmendjeje nga psikologia. 85% e fëmijëve kanë mirëqenie të mirë emocionale; 15% kanë mirëqenie të dobët (89 fëmijë 4-19 vjeç të vlerësuar në tetor 2023).

Seancat logopedike janë organizuar për 3 fëmijë me mbështetjen e OJQ-së PEMA.



Mbështetje psikologjike:

- ▶ 432 seanca individuale;
- ▶ 70 takime individuale me prindër;
- ▶ 23 vlerësime psikiatrike/neurologjike;
- ▶ Seancat grupore janë mbajtur dy herë në javë;
- ▶ Vlerësimi i mirëqenies emocionale të çdo fëmije çdo 6 muaj.



Në Partneritet me DIAKONIE Prizren (Qendra Psikosociale për Terapinë e Traumës) janë organizuar 12 seanca grupore psikologjike për të rinjtë.

Këshillim Social

Komunitetet në komunën e Prizrenit kanë një vetëdije të shtuar për të drejtat e fëmijëve, dhe fëmijët dhe të rinjtë në rrezik i drejtohen CONCORDIA-s për ndihmë dhe këshillim.

Një ekip profesional multidisiplinar forcon sistemin lokal të shërbimeve sociale në komunën e Prizrenit.

Familjet janë mbështetur për të marrë të drejtat e tyre sociale si shtesa për aftësi të veçanta dhe mbështetje për fëmijët e tyre, madje edhe regjistrimi i fëmijëve të tyre në gjendjen civile, apo me aplikimin për subvencione të ndryshme.

Mbështetja sociale:

- ▶ 59 nga 60 familje me të cilat CONCORDIA ka kontrata shërbimi ishin “shumë të kënaqur” me shërbimet që morën në Qendrën Tranzit (Anketa e Kënaqësisë Interne, Dhjetor 2023).
- ▶ 97,9 % e fëmijëve dhe të rinjve janë shumë të kënaqur me aktivitetet në Qendrën Tranzit.



252 pako familjare me përmbajtje ushqimore dhe produkte higjienike janë shpërndarë për pjesëmarrësit e programit (familjet).

5 familje me të porsalindur kanë marrë pako mujore për foshnje.



Mbështetja shëndetësore dhe Edukimi shëndetësor

Mbështetja shëndetësore u dëshmuar si një nevojë e madhe për fëmijët dhe familjet e tyre, duke pasur parasysh sistemin e dobët mjekësor në vend, pa mbulimin e sigurimeve shëndetësore, si dhe burimet e kufizuara të prindërve. Ndikimi i pritshëm tek fëmijët, pas ofrimit të shërbimeve edukative, emocionale dhe shëndetësore, është fuqizimi i tyre në individë të qëndrueshëm emocionalisht, socialisht të aftë dhe fizikisht të shëndetshëm.

Mirëqenia shëndetësore matet duke përdorur një instrument të zhvilluar brenda vendit që përfshin 10 artikuj; 127 fëmijë të moshës 2 deri në 18 vjeç janë vlerësuar dhe rezultatet janë si më poshtë:

- 60,6% (77 fëmijë) kanë shëndet dhe mirëqenie të mirë;
- 39,4% (50 fëmijë) kanë të paktën një problem shëndetësor ose mungesë higjienë;
- 24,4% (31) janë nën mbikëqyrje sa i përket higjienës së trupit dhe flokëve (bëjnë dush në qendër);
- 4,7% (6) janë nën trajtim stomatolog;
- 9,4% (12) janë nën mbikëqyrjen e një psikiatri, duke marrë seanca psikologjike në Tranzit dhe mjekime të rekomanduara;
- Për një fëmijë ne organizuam kontrolle gjenetike për të përcaktuar nëse ajo ka sindromën Down;
- Për 3 fëmijë janë organizuar seanca logopedike;
- 1 fëmijë është nën mbikëqyrje me dioptri;
- 1 fëmijë ka skoliozë.
- 80% (nga 65 fëmijë) -përmirësimi shëndetësor dhe i mirëqenies emocionale.



Dy (2) fushata vaksinimi janë organizuar në partneritet me OJQ Balkan Sunflowers.

- 447- numri total i mbështetjes shëndetësore e ofruar në Qendrën Tranzit gjatë vitit 2023;
- 137- vizita mjeksore;
- 132- individ pranuan barëra.

Mbështetja e të ushqyerit:

- 10, 825: Zamra/mëngjes;
- 18, 675: Porcione ushqimi.

Health
is wealth

Për 7 gra është siguruar mamografia nga ana e Infermierit, ku ky ekzaminim ishte hera e parë për të gjithë prej tyre.



Ekipi Mobil

Ekipi Mobil, i përbërë nga profesionistë të përkushtuar si punëtorë socialë, infermierë dhe psikologë, del në teren pa u lodhur mesatarisht dy herë në javë për të mbështetur familjet e rrezikuara në Prizren dhe fshatrat përreth. Përpjekjet e tyre përfshijnë vizita nëpër shtëpi, ndihmë me kujdes të specializuar mjekësor, sigurimin e të drejtave dhe përfitimeve sociale dhe regjistrimin e fëmijëve në shkollë.

Ekipi aktualisht mbështet 10 familje: 5 nga fshati Piranë, 2 nga fshati Zhur dhe 3 nga lagjet tjera të Prizrenit. Çdo familje zakonisht vizitohet një herë në javë, duke rezultuar në gjithsej 120 vizita familjare. Ekipi Mobil ofron gjithashtu ndihmë të drejtpërdrejtë duke përfshirë ushqime, produkte sanitare dhe higjienike dhe dru për familjet e identifikuara, nga të cilat vetëm 5 familje kanë përfituar dru dhe 10 familjet kanë marrë pako ushqimore dhe higjienike.

Në fund të vitit, ekipi vlerësoi familjet dhe vendosi të ndërpresë kontratat e dy (2) familjeve, çështjet e të cilave janë zgjidhur, duke i hapur rrugë familjeve të reja në janar. Ekipi Mobil gjithashtu ka referuar katër raste të punës së fëmijëve në Qendrën për Punë Sociale. Këto raste u hetuan nga ekipi dhe rezultuan në kthimin e fëmijëve në shkollë dhe në Qendrën Tranzit pasi prindërit e tyre u këshilluan. Ky Ekip ofron gjithashtu shërbime thelbësore si transporti për në seancat e fizioterapisë, shpërndarjen e mjeteve shkollore dhe transportin për klasat e muzikës në Qendrën Tranzit.

Veç kësaj, ofrohet këshillimi profesional për fëmijët më të rritur dhe shpërndahen pako ushqimore dhe higjienike. Gjatë gjithë vitit, Ekipi Mobil kreu 271 seanca individuale të këshillimit familjar dhe 120 vizita familjare.



Tre nga stafi janë të licencuar në nivel profesional për Shërbime Sociale.



**Qëndrueshmëria dhe
Shpresat e një familjeje**



Në Komunën e Prizrenit, familja e Mejreme G. mishëron si realitetin e ashpër të vështirësive ekonomike ashtu edhe forcën e palëkundur të shpirtit njerëzor. Ajo është një e ve për dhjetë vitet e fundit që është përballur me sfida të paimagjinueshme duke rritur pesë fëmijët e saj në një shtëpi të vogël dhe të varfër.

Kushtet e jetesës së familjes janë të rënda, me hapësirë të pamjaftueshme dhe sanitari të dobët por, megjithatë Mejremja ka qëndruar me një vendosmëri të fortë.

Mejremja vuan prej problemeve kronike, duke i shtuar një shtresë tjetër vështirësie përditshmërisë së saj. Pavarësisht vështirësive të saj, ajo ka arritur të mbajë familjen e saj të bashkuar dhe të sigurojë të mira, aq sa mundet.

Djali i saj i madh, Gjelbrimi, tashmë 25 vjeç, është i martuar me Suzana M. dhe ka një vajzë dy vjeçare, Sejdinën, e cila që nga lindja po lufton me paralizën e trurit.

Gjelbrimi punon kohë pas kohe (sipas nevojës si punëtorë krahu), duke prerë dru gjatë stinës së dimrit ku dhe të ardhurat e tij, nuk mjaftojnë për t'i plotësuar nevojat e familjes.



Leutrimi, 22 vjeç, punon në ndërtim, ndërsa Hasani, 20 vjeç, është i papunë. Asnjëri nga dy vëllezërit nuk ka pasur mundësi të ndjekë shkollën.

Valtoni, 15-vjeçar, ka braktisur shkollën pas klasës së tretë. Mes këtyre fatkeqësive, Edisona, më e vogla në moshën 12-vjeçare, shkëlqen si një fener shprese. Ajo është një nxënëse e zellshme në klasën e shtatë dhe së fundmi ka filluar mësimet e kitarës në Qendrën Tranzit, duke demonstruar përkushtimin e saj për të mësuar dhe për t'u përmirësuar.

Familja nuk përfiton asnjë ndihmë sociale, përveç pensionit modest invalidor që i është dhënë Sejdinës së vogël, falë mbështetjes së CONCORDIA-s. Ky pension do të vazhdojë deri në fund të jetës së saj, duke siguruar një fije të hollë, por vendimtar.

Si një ekip mobil i CONCORDIA-s, ne jemi të përkushtuar të mbështesim Mejremen dhe familjen e saj duke iu ofruar mbështetje shëndetësore dhe transport për seancat e fizioterapisë së Sejdinës, materiale shkollore për Edisonën dhe transport për klasat e saj të muzikës në Tranzit.

Gjithashtu, e furnizojmë familjen me pako ushqimore dhe higjienike si dhe këshillim profesional për fëmijët më të rritur.

Pavarësisht sfidave të tyre dërrmuese, Mejremja dhe fëmijët e saj vazhdojnë të përballen çdo ditë me një qëndrueshmëri dhe shpresë. Tregimi i tyre është një dëshmi e forcës së shpirtit njerëzor dhe ndikimit të thellë të mbështetjes së komunitetit.

Nëpërmjet të përpjekjeve tona të vazhdueshme, ne synojmë të ndihmojmë familjen e Mejremes jo vetëm të mbijetojë, por të lulëzojë, duke i sjellë më afër një të ardhmeje të mbushur me mundësi më të ndritshme.



Grupi për Mbështetjen e Grave

Në janar 2023, është formuar një grup i ri për mbështetjen e grave, një grup prej 10 grash që do të udhëhiqen nga psikologja e re.

10 gratë e GMG-së, kanë marrë pjesë në dymbëdhjetë (12) module gjatë vitit, një modul në muaj, duke mbuluar tema të ndryshme si kuptimi personal dhe eksplorimi emocional, edukimi financiar, zhvillimi i të menduarit kritik, komunikimi, kreativiteti, perceptimi, të drejtat e grave. etj.

Në fund të vitit, pjesëmarrëset u shpërblyen me certifikata për pjesëmarrje dhe dhurata simbolike.






Gjithashtu, një nga takimet mujore ishte me fokus paragjykimet dhe hapësirat personale, aspekte të lidhura me dhunën në familje me rastin e 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave.


Gjatë vitit 2023 janë organizuar dy ekskursione me prindërit në ambiente të ndryshme ku relaksimi i bëri ata të jenë mjaft të hapur me aktivitetet e propozuara nga psikologjia dhe mësuesja e Tranzitit.

Më 27 qershor, gratë/nënat udhëtuan drejt Prishtinës dhe vizituan sallonin e bukurisë së Miss Shqipëria 2022. Tema ishte: **“Dëshirat na udhëheqin në profesionin tonë”** ! Përveç që zsh. Elona Ndrecaj (Miss Shqipëria 2022) ishte një mikpritëse e mrekullueshme, i gjithë grupi i grave patën kënaqësinë të bënin trajtime të ndryshme bukurie, pa pagesë.



Më 30 maj është organizuar një ekskursion ku tema ka qenë: empatia me fëmijën e tyre, të kuptojnë dhe të krijojnë marrëdhënie të mira me ta. Si përfundim ishte se frika më e madhe, sidomos për gratë se mos fëmijët e tyre do t'a përsërisin gabimin e njëjtë të prindërve, duke u martuar shumë herët.

Aktivitetet e GMG-së, u mbështetën veçanërisht përmes një granti të ofruar nga Land Vorarlberg nga Austria, projekti: **“Fuqizimi i Grave të Kosovës (EWOKOS) 2.0”** -tejkalimi i pabarazisë tradicionale gjinore dhe formimi në mënyrë aktiv e një të ardhmeje më të mirë, me një veçanti: fokusimi në përmirësimin e mirëqenies emocionale dhe fizike të vajzave dhe grave nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.



Në këtë projekt, rolet e rëndësishme të grave u fokusuan në orët e shkrim-leximit si dhe në punëtoritë e qepjes. Në punëtorinë e rrobaqepësisë, gratë prodhuan tutu funde për vajzat parashkollor për eventin e 20 Nëntorit.



Në emër të Ditës Ndërkombëtare të Gruas më 8 Mars, në Qendrën Tranzit u zhvillua një punëtori e dedikuar për higjienën, një nismë kryesore që synon promovimin e mirëqenies së grave dhe vajzave. Gjithsej 50 gra u pajisën me produkte esenciale higjienike, duke kontribuar ndjeshëm në shëndetin dhe komoditetin e tyre të përgjithshëm.




Më 30.09.2023 të gjitha gratë e GMG-së dhe disa vajza të ishin për të parë filmin “Romni” në kinemanë Lumbardhi në Prizren. Ky film dokumentar (bazuar në një tregim të vërtetë) është shfaqur si pjesë e fushatës **"Martesa nuk është për fëmijë"**, organizuar nga Organizata Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve, si produksion i UNMIK-ut (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë) me qëllim të ndërgjegjësimit për martesat e hershme.

Pas shfaqjes së filmit, u mbajt një debat për parandalimin e temës në fjalë.

Panelistë ishin: Valbona Belallari, Psikologe e Qendrës Tranzit, Luljeta Demolli - Qendra Kosovare për Studime Gjinore, Hysnije Berisha, Këshilltare Politike për Çështje Juridike në MAPL, ku kanë diskutuar strikt për martesat e hershme.





Spiritualiteti

Takime mbi spiritualitetin me fëmijët janë organizuar çdo muaj, duke u fokusuar në tema si Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, Dita kundër Punës së Fëmijëve dhe një vizitë në ekspozitën e Holokaustit "Diagnoza racore: Cigan".



Aktivite të veçanta nën temat e spiritualitetit kanë përfshirë diskutime mbi kulturën dhe vlerat greke, fenë dhe vlerat në Afrikë, Holokaustin dhe racizmin kundër Ciganëve gjatë Luftës së Dytë Botërore, rëndësinë e Ramazanit në fenë myslimane, shikimin e filmit "Matilda" dhe dhurimi tek të varfërit

Më 9 qershor, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare kundër Punës së Fëmijëve, temë diskutimi ishte rëndësia e edukimit në jetën e fëmijëve, duke theksuar se puna e fëmijëve është abuzim ndaj fëmijëve. Përveç pjesëmarrësve të programit nga Qendra Tranzit, ishin të pranishëm edhe vullnetarë nga Gjymnazi i ALG-së.

Mesazhi ishte: **"Të fitojnë dije, e jo para"**. Grupi ynë i Spiritualitetit pati një ditë të të bukur duke vizituar një xhami dhe një kishë, me përforcimin e idesë në thelb, se ne të gjithë jemi të lidhur nga njerëzimi ynë i përbashkët.

Në fund të vitit, u organizua një seancë spiritualiteti rreth dy pyetjeve: "Sa të rëndësishme janë për ju festat e fundvitit?" dhe "Si mund ta përshkruani vitin që lamë pas me tre fjalë?"



Këshillim Profesional

Grupet e reja të Këshillimit Profesional për vitin 2023 përbëheshin nga 10 të rinj/adoleshentë.

Seanca e parë e “Këshillimit Profesional” u zhvillua më 19 janar, ku ishte një takim prezantues me temën: “ëndrrat e tyre”.

Qëllimi më i rëndësishëm i këshillimit profesional është të kontribuojë në zhvillimin holistik të fëmijëve dhe të rinjve, duke mbështetur kalimin e tyre në botën e punës dhe vendimmarrjes, ku të rinjtë përpiqen për një përmirësim të vazhdueshëm gjatë gjithë jetës së tyre. KP-ja mund t'i ndihmojë fëmijët dhe të rinjtë të përcaktojnë më mirë ëndrrat dhe interesat e tyre dhe rëndësinë e qëndrimit në shkollë dhe pjesëmarrjes në jetën e komuniteteve të tyre.

Duke filluar herët me fëmijët, rreth moshës 14 vjeç, me këshillimin profesional, ne zgjerojmë kuptimin e tyre për zgjedhjet e ardhshme të punës, duke i udhëzuar ata të gjejnë rrugën e duhur arsimore për të arritur dëshirat e tyre.

Temat e diskutimit për takimet mujore ishin: bankat dhe roli i bankave në Kosovë, modeli shembull, puna vullnetare, mediat sociale, puna praktike, puna e fëmijëve, etj.

Në muajin maj u zhvillua një seancë e Këshillimit Profesional (KP-ësë) me temën: “modeli shembull” rëndësia e edukimit dhe menaxhimi i konflikteve ku prezenca e të ftuarve specialë ishin:

Dr. Bernhard Drumel (Kryetari i CONCORDIA Projekte Sociale), znj. Elena Matache (Drejtoreshë e Zhvillimit Ndërkombëtar të CONCORDIA International), znj. Gjyzel Shaljan (ME) dhe z. Fatmir Morina nga OJQ “Foleja”.



Temat e muajit korrik të takimit të Këshillimit Profesional (KP) ishin: 1. Puna vullnetare; dhe 2. Rëndësia e punës praktike dhe vullnetare në përgatitjen e industrisë së punës.



Lidhur me këtë, u organizua një vizitë në fabrikën “Frutex” L.L.C në Suharekë ku nxënësit e Këshillimit Profesional dhe të shkollave të mesme të CONCORDIA Qendrës Tranzit ishin ligjëruar me një prezantim konciz me linjën e plotë të prodhimit dhe produkteve të fabrikës.

Lidhur me temën: rëndësia e detyrës, menaxhimi i kohës dhe puna ekipore, Këshillimi Profesional dhe stafi nga CONCORDIA Bulgaria patën një seancë të përbashkët, por në të njëjtën kohë argëtues, ku të rinjtë arritën të mësojnë për detyrën - rëndësinë e punës ekipore dhe menaxhimin e kohës.

Muaji Nëntor ishte frymëzues për të rinjtë. Në kuadër të projektit të Këshillimit Profesional dhe të Orkestrës së Tranzitit u organizuan dy aktivitete. I pari ishte një udhëtim 1 ditor në Tiranë, ku ata vizituan “Muzeun e Gjethëve” dhe mësuuan për regjimin komunist, e më pas u takuan me përfaqësuesit e OJQ-së IRCA (Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri) ku inçizuan një këngë në studion muzikore të kësaj organizate. Ky udhëtim ka ndihmuar tek të rinjtë të njihen me disa profesione të reja.

Aktiviteti i dytë për të rinjtë ishte vizita në kompaninë Liri.

Pas aplikimit në thirrjen e hapur nga Kosovo Makers League Foundation, ne jemi përzgjedhur për të marrë pjesë në garat e robotikës 'KOSOVO MAKERS LEAGUE OPEN' 2023-2024, ku 4 të rinj do të mësonin të programojnë robotë të vegjël nën udhëheqjen e një prej stafit tonë e cila ishte trajnuar për të qenë mentor i tyre.

Një grup të rinjsh u trajnuan për tre (3) ditë në programin Arduino (si të ndezet një LED; si të ndriçojnë 4 drita me potenciometër; dhe si të punojë një motor i vogël, etj. me mbështetjen e një Vullnetar Ndërkombëtar.

Të rinjtë morën pjesë në disa evinimente në Mitrovicë, në kuadër të projektit “Harmonizimi i Diversitetit - Iniciativa Ballkanike për Shkëmbimin e Muzikës Rinore” në partneritet me OJQ-në ARS Kosova.

Me rastin e festimit të Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Rome, të rinjtë tanë entuziastë vizituan Bibliotekën Rome në Durmish Asllano në Prizren. Intervistat e shkurtra të 3 të rinjve u promovuan në Facebook për Ditën Botërore të Fuqizimit të Rinisë.

Në dhjetor, si mirënjohje për punën e palodhur, përkushtimin e secilit prej anëtarëve të Këshillimit Profesional për rrugëtimin e tyre profesional, u shpërblyen me Çertifikata Mirënjohjeje dhe dhurata simbolike.



Një storie suksesi



Një storie shprese!

Bajra, është një vajzë 16-vjeçare nga një familje katër anëtarë, e përballuar me sfida të mëdha kohëve të fundit.

Nëna e saj ndërroi jetë tragjikisht pas një sëmundjeje të gjatë, duke lënë të atin si mbajtës i vetëm i familjes. Kjo familje ballafaqohet mjaft me vështirësi ekonomike ku Bajra dhe dy motrat e saja kanë marrë tërë përgjegjësinë shtëpiake.

Fillimisht, Bajra ishte e pasigurt për vazhdimin e shkollimit të mesëm për shkak të rrethanave të vështira.

Megjithatë, falë bisedave të shumta me stafin e CONCORDIA-s, ajo u bind për rëndësinë e arsimit në të ardhmen e saj. Kjo shënon një kthesë të rëndësishme pozitive, pasi arsimimi mund të hapë dyert për mundësi më të mira, veçanërisht në situata të vështira.



Bajra, jo vetëm që është një vajzë e vendosur por edhe e talentuar. Ajo luan në violonçelo në Orkestrën Tranzit, duke treguar aftësitë e saj muzikore. Përveç talentit ndaj çelos, asaj i pëlqen edhe vizatimi, i cili shërben si një prizë krijuese dhe një aftësi e mundshme për të ardhmen e saj.

Duke u bazuar në interesat dhe talentet e saj, Bajra ka zgjedhur të regjistrohet në shkollën mesme Teknike në drejtimin e dizajnit të modës. Ky vendim proaktiv nxjerr në pah angazhimin e saj për të ndjekur pasionet e saja dhe për të fituar aftësi që mund t'i sjellin dobi në planin afatgjatë.

Tregimi i Bajrës është një shenjë e aftësisë dhe vendosmërisë së saj për të vazhduar shkollimin dhe për të eksploruar talentet, pavarësisht vështirësive.

Qendra CONCORDIA Tranzit ofron dhe do të ofrojë mbështetjen dhe inkurajimin e nevojshëm për të gjithë të rinjtë si Bajra, duke i ndihmuar ata të lundrojnë në sfidat e tyre dhe të punojnë drejt një të ardhmeje më të ndritshme.



Shkolla për Prindër

Seanca e parë e "Shkollës për Prindër" u mbajt në janar 2023, me 10 anëtarët e rinj që do të vijonin 12 (dymbëdhjetë) module (sipas manualit të SHP-së) një herë në muaj ku temat ishin: rëndësia e komunikimit prind-fëmijë, bashkëpunimi i prindërve me edukatorët dhe mësuesit, ndryshimi i qëndrimeve dhe normave shoqërore të tyre duke vazhduar edukimin e vajzave dhe të grave, edukimi financiar (me mbështetjen e vullnetarëve), përgjegjësitë e prindërve, t'i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë, marrëdhëniet e punës dhe të drejtat si dhe diskriminimi etnik.

Qëllimi i takimeve ishte edukimi i prindërve për të mbështetur fëmijët e tyre për vazhdimin e shkollimit, duke pasur kështu mundësi më të mira në jetën e tyre dhe për të thyer ciklin e varfërisë. Mentalitetet, besimet kulturore dhe mungesa e të kuptuarit janë aspekte që duhen trajtuar për një kohë të gjatë.

Disa nga takimet me prindër organizoheshin edhe gjatë ekskurzioneve apo vizitave, si një ekskursion në liqenin e Dukagjinit në Gjakovë, ku qëllimi i këtij diskutimi ishte ndërgjegjësimi i prindërit- empatia dhe të kuptuarit e fëmijëve të tyre.

Një takim tjetër përfshinte vizitën e ekstopozitës së Holokaustit "Diagnoza racore: Cigan" që i nënshtrohej diskriminimit racor gjatë Luftës së Dytë Botërore ndaj popullit Sinti dhe Romëve të Evropës Qendrore dhe të asaj Lindore.

Bashkëpunimi me Policinë lokale u shtua dukshëm– dy aktivitete të organizuara në Tranzit me prindër dhe adoleshentë për të diskutuar mbi martesat e hershme, lëmosh kërkimin nëpër rrugë, braktisjen e shkollës, punën e fëmijëve, dhunën në familje, duke synuar rritjen e njohurive për dënimet e mundshme ndaj prindërit sipas ligjit.

Përveç të lartpërmendurave, projekti i shkollës për prindër ka pasur edhe takime mujore me fokus për kujdesin dhe higjienën e fëmijëve.



Në dhjetor prindërit festuan përfundimin e dymbëdhjetë moduleve me një ushtrim reflektimi duke marrë pjesë në Koncertin e Fundvitit në Qendrën Tranzit ku dhe u shpërblyen me Çertifikata Mirënjohjeje dhe dhurata simbolike.

Mbrojtja e fëmijëve dhe parandalimi i dhunës

Në CONCORDIA, mbrojtja dhe mirëqenia e fëmijëve janë prioritetet tona kryesore.

Si një organizatë e ndihmës për fëmijët, ne jemi të përkushtuar për të mbrojtur fëmijët në rrezik dhe për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve.

Të drejtat e fëmijëve janë një bazë solide për ne në punën tonë të përditshme. Andaj, për këtë arsye, ne vendosëm që mekanizmat tanë të brendshëm të mbrojtjes së fëmijëve të auditohen nga organizata e pavarur Keeping Children Safe. Falë mbështetjes financiare të partnerit tonë Remus Innovation GmbH, ne ishim në gjendje të përdornim burimet e nevojshme për çertifikim të shpejtë në mënyrë që të rishikonim dhe çertifikonim udhëzimet tona për mbrojtjen e fëmijëve. Ky auditim ishte vendimtar për ne për t'u siguruar që masat tona për mbrojtjen e fëmijëve i përmbushin standardet më të larta.



Si një organizatë e ofrimit të ndihmës për fëmijët, mbrojtja e fëmijëve është një prioritet kryesor.



Martina Raytchinova,

*Zyrtare Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve
në CONCORDIA Projektet Sociale*

” Çertifikimi ka një rëndësi shumë të madhe për ne, ashtu edhe siç është mbrojtja e fëmijëve prioriteti ynë kryesor. Ne punojmë me fëmijët çdo ditë dhe jemi krenarë që mekanizmat tona të mirëfunksionimit të mbrojtjes së fëmijëve ndihmojnë në mbrojtjen e tyre nga çdo dëm në mënyrën më të mirë dhe të mundshme. Në të njëjtën kohë, ne e shohim çertifikimin si njohje të punës dhe angazhimit të ekipeve tona.





Klasat e Muzikës

Në janar 2023, u organizua një aktivitet nga “Parlamenti i Fëmijëve”, ku u ftuan të gjashtë mësuesit e Instrumenteve Muzikore për t'i shpjeguar informacionet bazë për instrumentet dhe muzikën për ata fëmijë që nuk janë regjistruar ende në asnjë instrument, ku interesi ishte i madh. Të njëjtët gjashtë (6) mësues të muzikës vazhduan t'i mësojnë fëmijët në Qendrën Tranzit, me të njëjtin numër të orëve në javë si gjatë vitit të kaluar: 3 mësues me 24 orë në muaj (piano, kitarë dhe violonçelo), 2 mësues me 32 orë/ muaj (violinë dhe flaut) dhe 1 mësues me 56 orë/javë (saksofon, klarinetë dhe dirigjent i orkestrës).

Labinoti, studenti ynë në universitetin e muzikës (tashmë në vitin e tretë të studimeve), jep vullnetarisht mësimin e baterive gjatë pushimeve verore.

Një sezon koncertesh në Qendrën Tranzit u hap më 22 mars me "Koncertin e Luleve" që ishte koncerti i dytë (2) solo i fëmijëve që performonin para prindërve të tyre. Ndërsa në emër të 18-vjetorit të ALG-së, u organizua ceremonia “Dita e dyerve të hapura”, një mundësi e mirë për miqtë, mbështetësit dhe shumë të ftuar të njohin shkollën ALG nga një dimension tjetër. Në këtë event, Orkestra e CONCORDIA Qendrës Tranzit ishte në mesin e atyre miqve që argëtuan pjesëmarrësit me disa pika muzikore.



Projekti i financuar nga Fondacioni Vita Activa na dha mundësinë për të vazhduar shkollën e muzikës.



Koncertet e mbajtura:

- Më 1 qershor, Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, Orkestra CONCORDIA Traznit mbajti një koncert në Qendrën Tregtare Galleria në Prizren;
- Më 21 Qershor, Ditën Botërore të Muzikës, "Festa e Muzikës" në Key, ku kanë performuar nxënësit e ALG-së dhe Orkestra e Traznit;
- Më 5 Nëntor, duke festuar Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Rome me harmoni dhe muzikë, Orkestra jonë performoi në Fushë Kosovë në ambientet e OJQ-së Kultura Multietnike e Kosovës;
- Më 9 nëntor, Orkestra Traznit performoi në Sallën e Muzeut të Mitrovicës. drejtuar nga Prof. Rustem Gashi. Përveç orkestrës sonë, të pranishëm ishin edhe shumë grupe të tjera muzikore nga mbarë Kosova, të cilët përfaqësuan bukur diversitetin e pasur kulturor të Kosovës. Ky eviniment u organizua nga OJQ Kosova ARS, për të gjitha komunitetet me mesazhin: "Nisma për Harmonizimin e Diversitetit", e cila dëshmon se të gjithë jemi një, pavarësisht përkatësisë etnike; dhe
- 28 Dhjetor, koncert i fundvitit në CONCORDIA Qendrën Traznit.



Klasat:

- 47 fëmijë dhe të rinj janë të regjistruar në klasat e muzikës (instrumente) dhe
- 18 në kor;
- 12 anëtarë në bateri;
- 26 anëtarë në Orkestrën e Traznitit.

Eventet

- Solo koncert "Koncert i Luleve" në Qendrën Tranzit;
- Pjesëmarrja e CONCORDIA Orkestrës Tranzit për Ditën e Romëve më 7 Prill;
- Pjesëmarrja në ekspozitën e orkestrës dhe vizatimeve në eventin Dyert e Hapura në Loyola (18 vjetori);
- Koncert më 1 Qershor në Galleria Shopping Mall: për nder të Ditës së Fëmijëve, ku orkestra jonë dha një koncert special;
- Koncert me 21 Qershor: Për të festuar Ditën Ndërkombëtare të Muzikës u mbajt një koncert në bashkëpunim me nxënësit e "LOYOLA GYMNASIUM";
- "LULU Dance Academy" me Galleria Mall - event për mbledhjen e fondeve që dy vajzat tona të talentuara të marrin pjesë në klasat e baletit;
- Koncerti i fundvitit nga CONCORDIA Orkestra Tranzit.



Gjatë vitit 2023 janë mbajtur takime të rregullta me Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Prizrenit dhe menaxhmentin e shkollës si: 'Ibrahim Fehmiu', 'Abdul Frashëri', 'Loyola' dhe '26 Marsi'.

Në nëntor 2023, nxënësit e ALG - Loyola-Gymnasium në Prizren morën Çertifikatën e Mirënjohjes për punën e tyre vullnetare në CONCORDIA Projekte Sociale Qendra Tranzit.



Aktivitetet tjera

Dy aktivitete “Next to CONCORDIA Van” (Afër furgonit të CONCORDIA-s”) janë organizuar për të mobilizuar fëmijët dhe prindërit nga zonat rurale për të ngritjen e ndërgjegjësimit për të drejtat e fëmijëve në Zhur dhe Landovicë.

Fëmijët nga CONCORDIA Qendra Tranzit përgatitën kartolina për festat e fundvitit për fëmijët në Zhur dhe Landovicë.



Janë organizuar katër (4) ekskursione për fëmijët në Qendrën Tranzit si shpërblim për rezultatet e tyre të mira qoftë në shkollë apo në lidhje me sjelljen e tyre në Qendër:

1. një ekskursion me të rinjtë në qendrën tregtare në Prishtina Mall (në bazë të kërkesës së Parlamentit të Fëmijëve drejtuar menaxhmentit) vizitë në këndin e lojërave dhe në kinema;
2. një ekskursion për fëmijët më të vegjël nga programi i edukimit në fëmijërinë e hershme Tranzit (2 – 6 vjeç) në këndin e lojërave të Qendrës Tregtare Galeria në Prizren;
3. një tjetër për të rinjtë dhe edukimin e hershëm duke vizituar ujëvarat e Korishës; dhe
4. “Mbroni dhe ruani kafshët e egra”: Më 14 korrik, fëmijët e vegjël të Qendrës Tranzit kanë vizituar “Pyllin e Arinjve” në Prishtinë. Ishte një moment i paharrueshëm dhe një lumturi e madhe për të gjithë ata të shihnin kafshët e egra.



Më 13 maj, grupi i pjesëmarrësve të programit të arsimit fillor morri pjesë në shfaqjen interaktive "Afërdita përsëri në shkollë" (Teatri i Prizrenit "Bekim Fehmiu"). Ishte një kënaqësi e madhe për fëmijët dhe publikun të ishin pjesë e çdo momenti të kësaj shfaqjeje.



Lumturia e fundvitit!

- Më 27 nëntor, fëmijët patën mundësinë të eksplorojnë dhe zbulojnë veshjet kombëtare, gatimet e lashta dhe monumentet historike në Muzeun e Lidhjes së Prizrenit.
- Për të mos harruar kohën më të mirë të gëzimit dhe lumturisë kur fëmijët kanë pritshmëritë më të mëdha në sezonin e festave të fundvitit!
- Nxënësit e ALG - Loyola-Gymnasium në Prizren të stolitur me kapelat e babadimrit dhe zemrat plot ngrohtësi sollën dhurata për pjesëmarrësit e programit tonë!
- Babadimri i Ekipit Mobil shpërndau dhurata duke krijuar gëzime në fytyrat e fëmijëve të cenuar në Landovicë, Zhur dhe Piranë si dhe tek fëmijët e Qendrës Tranzit.
- Galeria Shopping Mall dhe një donator anonim preku zemrat e fëmijëve tanë duke sjellur qindra dhurata të bukura për fëmijët.

Këto gjeste treguan se fryma e dhënies nuk njih kufij dhe mund të ketë vërtet një ndikim domethënës në jetën e atyre në nevojë, veçanërisht gjatë sezonit festiv.





”

Më duket e tmerrshme që në zemër të Evropës ka ende vende ku gjysma e fëmijëve janë në rrezik të varfërisë ekzistenciale. Prej shumë vitesh, CONCORDIA është duke ofruar duart aty ku nevoja është më e madhe. Ne do të çojmë përpara këtë mision me të gjitha forcat tona. Asnjë fëmijë nuk duhet të lihet pas.

Dr. Bernhard Drumel

Kryesues i Bordit të CONCORDIA-s në Kosovë

Takimet/Vizitat/Vizibiliteti

- Më 8 mars në CONCORDIA Qendrën Tranzit u organizua “Tryeza e rrumbullakët për Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë – barrierat dhe mundësitë”.



- Më 24 Prill, Qendrën tonë e nderoi me vizitë znj. Elizabeth Gowing, Këshilltare për Çështjet e Komuniteteve të zyrës së Kryeminsitrit, znj. Nuriye Shala, Këshilltare Politike e Kryeministrit, dhe znj. Manuela Petroviç.



- Në fillim të muajit maj, u organizua një vizitë studimore në Rumani për stafin e Qendrës.



- Më 29 maj, CONCORDIA Qendra Tranzit pati nderin të mirëpriste z. Alien Ciocănea, Shefin e Zyrës Ndërlidhëse të Rumanisë në Prishtinë.



- Më 2 qershor, Kryetari i Komunës së Suharekës ka vizituar Qendrën Tranzit.



- Në shtator, CONCORDIA Projekte Sociale u bë anëtare e KOMF-it (Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë).



- Gjatë periudhës korrik-shtator është kryer studimi i fizibilitetit për identifikimin e Komunës në më nevojë për hapjen e Qendrës së Dytë Ditore.

Takimet/Vizitat/Vizibiliteti

- Më 2 tetor janë organizuar takime në mes të Kryesuesit të Bordit të CONCORDIA-s në Kosovë dhe Drejtoreshës Ekzekutive të zyrës në Prizren me Kryetarët e KK Prizren dhe Gjakovë.



- Zëvendësministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dha një intervistë gazetarit austriak që vizitoi CONCORDIA Qendrën Tranzit në fillim të nëntorit me temën “sfidat dhe arritjet e komunitetit Romë në Kosovë”, duke theksuar rolin dhe ndikimin e rëndësishëm që CONCORDIA ka në jetën e fëmijëve, familjeve dhe të komuniteteve.



- Kah mesi i nëntorit, CONCORDIA Qendra Tranzit e mirëpriti z. Martin Lenz, Shefin e Departamentit për Projekte dhe Bashkëpunim Projektesh- Fondacioni Renovabis.




- Në nëntor, Qendrën tonë e vizituan përfaqësuesit e Misionit të OSBE-së në Kosovë ku tema e diskutimit ishte kryesisht për përvojën e CONCORDIA-s në organizimin e një qendre mësimore sipas legjislacionit vendor të Ministrisë së Arsimit.



- Eventi më i madh i vizibilitetit për shkak të audiencës më të madhe dhe transmetimit nëpër TV stacione vendore si dhe të mediave sociale të ndryshme ishte event i “Jepni fëmijëve krahë” që u mbajt më 20 Nëntor, në Galeria Shopping Mall Prizren, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve. (dita kur u nënshkrua Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijëve).
- Qëllimi ishte manifestimi dhe avokimi për të drejtat e fëmijëve, duke ofruar një platformë për palët e ndryshme të interesit që të bashkohen në mbështetjen e kauzës. Një event i tillë u organizua për të parën herë në Prizren, që ishte një sukses i jashtëzakonshëm, duke bashkuar një grup pjesëmarrësish, donatorësh dhe komunitetin lokal.







”


Ndjenjë i të qenit së bashku është të afrojmë njerëzit që duan të ndihmojnë dhe ata që kanë nevojë për ndihmë në kontakt me njëri-tjetrin dhe të krijojmë një rrjet që siguron kohezionin në shoqërinë tonë dhe shumë më gjerë.

*P. Markus Inama SJ
Anëtar i Bordit*

Burimet e fondeve - Sipas donatorëve

- CONCORDIA Projekte Sociale ka Statutin e Përfitimeve Publike që nuk paguan TVSH.


Buxheti total në Euro	389,633.00 €	100%
Jesuitenweltweit	60,582.00 €	16%
Vita ACTIVA	20,588.00 €	5%
CONCORDIA Projekte Sociale	67,004.00 €	17%
Renovabis /KZE	214,935.00 €	55%
Land Vorarlberg	10,001.00 €	3%
Donatorë të tjerë	16,524.00 €	4%
Përqindja e vetëfinancimit		
80%		



Llojet e kostove

Totali i donacioneve për vitin 2023		
	391,720.00 €	100%
Fondet/pasuritë e kufizuara PPE	2,087.00 €	1%
Të ardhurat e njohura	389,633.00 €	
Kostot	79,654.00 €	20%
Transporti	29,081.00 €	7%
Të tjera	23,801.00 €	6%
Kostot operative	12,806.00 €	3%
Mirëmbajtja dhe riparimi	4,060.00 €	1%
Interesat, Taksat, Sigurimet	3,126.00 €	1%
Personeli	224,666.00 €	57%
Inventari i ulët	1,722.00 €	0%
Amortizimi	48,334.00 €	
Shpenzimet e përgjithshme	427,250.00 €	
Suficiti/deficiti për vitin*	(35,530.00) €	

*Deficiti është për shkak të amortizimit të pasurisë së dhuruar.



Opinionimi i Auditorit!

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të CONCORDIA - Projekte Sociale ("Organizata"), të cilat përbëhen nga Pasqyra e Pozicionit Financiar me 31 dhjetor 2023, Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse, dhe pasqyra e Rrjedhës së Parasë për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit. Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të 'CONCORDIA - Projekte Sociale' më 31 dhjetor 2023 dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë së gatshme për vitin e përfunduar më datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe kërkesat e Ligjit Nr. 06 / L 043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, siç përcaktohet në Shënimin 2. të pasqyrave financiare.

Mirënjohje/Falenderim!

Donatorët

- Një mirënjohje për mbështetjen të gjithë donatorëve, sponsorëve dhe partnerëve tanë.



jesuiten*weltweit*
MENSCHEN FÜR ANDERE | www.jesuitenmission.at



STRABAG

FRUTEX

GALERIA
SHOPPING MALL



Miss Shqipëria 2022
Zsh. Elona Ndrecaj



GJIRAFJA JOY



BELI SH.P.K



MY MARKET
PRIZREN

Donatorë privat: Mr. Ahmad Shamim

Filialat: KOMF; CIVIKOS.

Partnerët: ALG LOYOLA; NGO PEMA ;
NGO KOSOVA ARS; DIAKONIE; VORAE.



Zyra Nacionale:

- Mirela Lavric - Drejtoreshë Ekzekutive
- Gjeneta Çoçaj - Drejtoreshë Financiare dhe Koordinatore e Programit për Qendrën Tranzit
- Arlinda Zhupi Muslu- Zyrtare e Projektit dhe për Komunikim /MP
- Uliks Hoxhaj- Grumbullues i Fondeve dhe Mësues i Kitarës

CONCORDIA Qendra Tranzit

- Mynever Basha- Mësuese, Pika Fokale për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Koordinatore e Shkollës për Prindër
- Saranda Berisha -Mësuese dhe Koordinatore e Qendrës Mësimore
- Valbona Belallari- Psikologe dhe Koordinatore e Grupit Mbështetës për Gra
- Dorentina Bytyqi- Punëtore Sociale dhe Koordinatore e Këshillimit Profesional
- Argenita Mijalica- Punëtore Sociale dhe Koordinatore e Ekipit Mobil

- Melisa Jurush- Mësuese
- Nehari Shporta- Infermier
- Krenar Mustafa- Asistent i Projektit
- Blerta Berisha - Edukatore Parashkollor
- Vlora Cakaj- Asistente e Edukatores
- Jetmir Mustafa- Edukator
- Rahmi Mustafa - Kuzhinjer
- Zoja Mersulaj - Mirëmbajtëse
- Ramadan Saiti - Roje Nate
- Skender Krasniqi - Roje Nate

CONCORDIA Qendra Tranzit Mësuesit e Muzikës

- Rustem Gashi - Mësues i klarinetit/saksofonit dhe dirigjent i CONCORDIA OrkestrësTranzit
- Adonis Gjini - Mësues i violonçelos
- Berat Tafallari - Mësues i Pianos
- Egzona Dullaj - Mësuese e Violinës
- Marigona Delija - Mësuese e Flautës

Ju falënderojmë për mbështetjen tuaj të vazhdueshme!



PUSH (Pika Unike e Shitjes)

CONCORDIA
Projekte Sociale,
është e vetmja OJQ në Kosovë
që posedon dy (2)
liçenca për: Qendrën
Mësimore dhe për Shërbime
Sociale të lëshuara nga
Ministria e Arsimit, Shkencës,
Teknologjisë dhe Inovacionit,
dhe nga
Ministria
e Drejtësisë.



Asociacioni CONCORDIA Projekte Sociale

Lahuta e Malësisë, 20000 Prizren / KOSOVO

office@concordia-kosovo.org, www.concordia-kosovo.org

<https://www.facebook.com/concordiaprojektesociale>

Numri i regjistrimit si OJQ: 5118824-1

Numri fiskal: 602444325

Raiffeisen Bank në Kosovë

IBAN: XK05 1501090004327049

BIC:RBKOKPR

